

VLERËSIMI I SITUATËS SË ARSIMIT TË LARTË NËN NDIKIMIN E COVID 19



Koha e realizimit:
Mars – Prill 2020

QENDRESA
QYTETARE



OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER



PËRMBATJA

1. HYRJE

2. METODOLOGJIA

3. VLERËSIM I MASAVE QEVERTARE PËR STUDENTËT NËN NDIKIMIN E COVID 19

3.1 QIRAJA E BANESAVE

3.2 AKSESI NË INTERNET

4 VLERËSIM I PERFORMANCËS SË UNIVERSITETEVE GJATË IZOLIMIT NGA PANDEMIA COVID 19

4.1 QASJA NË KOHË DHE CILËSI E UNIVERSITETEVE NDAJ MËSIMIT ONLINE

4.2 METODOLOGJIA E MËSIMIT ONLINE DHE VLERËSIMIT (PLATFORMAT E-LEARNING)

4.3 ANALIZË KRAHËSIMORE ME UNIVERSITETIN E PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

4.4 ANALIZË E INVESTIMEVE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË PLATFORMAT INFORMATIKE

4.5 KRAHËSIMI DHE RANKIMI I 9 UNIVERSITETEVE PUBLIKE

5. GJETJE KRYESORE

6. REKOMANDIME

Ky studim u realizua nga Qëndresa Qytetare në kuadër të projektit “Arsimi në Fokus”, me mbështetjen financiare të qeverisë suedeze dhe Olof Palme Center. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

1. HYRJJE

Në datën 9 Mars 2020 Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e ndikuar nga situata e krijuar nga pandemia Covid 19 nxorri Urdhërin nr. 91 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”.¹Menjëherë pas këtij Urdhëri, shkollat e arsimit parauniversitar dhe universitetet ndërprejnë procesin mësimor. Ndërpreja e procesit mësimor u shoqërua me sfida të shumta të aplikimit të mësimin alternativ online. Por kjo lloj qasje e gjeti sistemin arsimor, institucionet e arsimit të lartë dhe familjet shqiptare të papërgatitura sa i përket efektivitetit, cilësisë dhe aksesit të nxënësve dhe studentëve në internet.

2. METODOLOGJIA

Gjetjet e këtij studimi bazohen në një proces vlerësimi të masave qeveritare dhe performancës së universiteteve gjatë kohës së izolimit për shkak të pandemisë Covid 19. Vlerësimi është realizuar nëpërmjet tre instrumentave kryesorë vlerësues:

1. **Pyetësor online me 720 studentë** në 9 universitete të targetuara gjatë periudhës 9 – 14 Prill 2020. Forma e realizimit të pyetësorit u mundësua nëpërmjet përdorimit të programit Google form duke dhe mbështetur nëpërmjet facebook ads.
2. Për të siguruar gjithëpërfshirje, shpërndarje të drejtë dhe plotësim vetëm nga studente, pyetësi u kushtëzua të shfaqej në mënyrë rastësore vetëm për të rinjtë e moshave 18-24 vjeç në të gjitha fashat orare dhe në të gjithë territorin e vendit. U targetuan të rinjtë të cilët dedektohen nga rrjeti facebook si grup interesi të fjaleve kyçe “Universitet” “Student” “Arsim”, si edhe duke u shpërndarë manualisht në rrjetet e grupeve universitare.
3. **Testimi i pyetësorit** u realizua me 20 studentë nga rrjeti i studentëve “Arsimi në Fokus” para nisjes zyrtare të anketimit.
4. **Intervista të strukturuar** me studentë dhe pedagogë nga secili prej 9 universiteteteve të përzgjedhura për të validuar dhe kuptuar më mirë gjetjet e pyetësorit online.
5. **Analizë dhe desk research** e masave qeveritare dhe performancës së universiteteve publike gjatë kohës së pandemisë Covid 19. Analiza e përshtatjes dhe mësimin onlinetë universiteteve publike u shtri edhe në rrafshin krahasimor në raport me Universitetin e Prishtinës dhe universitete të tjera në Rajon dhe Europë.

¹<https://arsimi.gov.al/urdher-nr-91-date-09-03-2020-per-nderprerjen-e-procesit-mesimor-ne-te-gjitha-institucionet-arsimore-publike-dhe-jo-publike/>

Kampionimi

Para përcaktimit të kampionit, stafi implemetues i projektit realizoi një përlogaritje të numrit të studentëve në secilin universitet të targetuar. Për të garantuar nivelin e besimit 95% me tolerancë gabimi jo më shumë se $\pm 5\%$, kampioni i përzgjedhur në të gjitha universitetet të marra së bashku ishte 720 studentë, apo 1% e popullatës. Niveli i besimit tek metodologjia e zbatuar për matjen e perceptimit të zbatimit të “Paktit për Universitetin” në fund të pyetësorit të projektit kërkimor ishte 95%. Statisticienët pranojnë një nivel prej 95% të besimit si një standart të pranueshëm, prandaj gjetjet e studimit janë të një niveli të lartë besueshmërie.

Sa i përket pjesëmarrjes gjinore në këtë pyetësor, 72% e studentëve të pyetur janë vajza dhe 28% e tyre djem. Ndërsa shpërndarja e studentëve të pyetur bazuar në ciklin e studimeve ka qënë proporcionalisht e ndarë bazuar edhe në numrin real të studentëve që studiojnë sipas ciklit të parë dhe të dytë. 73.8% e studentëve pjesëmarrës në pyetësor i përkasin nivelit bachelor dhe 26.2 nivelit master.

PJESËMARRJA NË PYETËSOR


 Totali i pyetësorëve:
720 Studentë

 Shpërndarë në:
9 Universitete

 Forma: **Online**
Koha: **9-14 Prill 2020**
Moha: **18-24 Vjeç**

Universiteti	Nr. i pyetësorëve
Universiteti i Tiranës	180
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	100
Universiteti “Fan Noli”, Korçë	50
Universiteti Politeknik i Tiranës	110
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	60
Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan	70
Universiteti Bujqësor i Tiranës	50
Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	50
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	50

Gjinia
28%  Djem
72%  Vajza



Niveli i Studimeve
73.8%  Bachelor
26.2%  Master



3. VLERËSIM I MASAVE QEVERTARE PËR STUDENTËT NËN NDIKIMIN E COVID 19

3.1 QIRAJA E BANESAVE

Qeveria publikoi **Aktin Normativ Nr. 12, datë 2.4.2020** me qëllim shtyrjen e pagesave të qirasë për 2 muaj, prill dhe maj për 3 kategori, biznesin e vogël që është mbyllur për shkak të situatës, familjarëve të regjistruar në punë, që kanë ndaluar punën për shkak të luftës dhe studentët që janë larguar për në banesat e tyre pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë.²

Akti synonte ti vintë në ndihmë të gjithë studentëve të cilët nuk janë të akomoduar në konvikt ose në familjet e tyre dhe kanë marrë një banesë me qira në një nga bashkitë universitare, ***“Të gjithë qiramarrësit studentë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.”***

Kushti që vendos ky akt për kategoritë e përfituesve është se studentët duhet të kenë lidhur paraprakisht një kontratë qiraje me qiradhënësin për të përfituar nga ky akt normativ, ***kusht që se pari përjashton nga përfitimi pjesën me të madhe të studentëve të cilët nuk kanë një kontratë qiraje me pronarët e banesave dhe duhet të përballojnë vetë pasojat.***


Së dyti Akti normativ nuk lehtëson barrën financiare të studentëve por vetëm i jep mundësi ta paguajnë me këste kur të rikthehen në bashkitë ku studiojnë, kur vlen të theksohet se një pjesë e mirë e studentëve kanë humbur punët në Tiranë dhe bashkitë e tjera universitare gjatë periudhës së izolimit, punë nëpërmjet të cilave ata mbulonin këto shpenzime. ***“Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, në mënyrë proporcionale dhe të dakordësuar me qiradhënësin, pas muajit maj 2020. Për ato kontrata që përfundojnë përpara afatit 31 maj 2020, detyrimi i prapambetur do të paguhet nga qiramarrësi brenda tre muajve pas datës 31 maj 2020”.*** Në të dyja rastet barra që do u lindë studentëve kanë marrë një banesë me qera, sidomos atyre të kryeqytetit, përpara se të shpallej gjendja e jashtëzakonshme do të jetë e lartë dhe me pasoja ekonomike tek ata dhe familjet e tyre. Qeveria nuk mori parasysh ankesat e studentëve dhe shoqërisë civile për të siguruar bonus qeraje për dy muaj ose disbursim të qerave nëpërmjet mospagimit të tarifave të studimit.

²<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200406150149AKT%20NORMATIV%20-%20QIRA.pdf>

Gjatë periudhës së studimit 33.8% e studentëve të pyetur banojnë në shtëpi me qira, 59.4% në banesat e familjeve të tyre dhe vetëm 6.8% në konvikt. Nisur edhe nga akti normativ lidhur me lehtësirat mbi qiratë, studentët që banonin me qira u pyetën nëse kanë lidhur një kontratë qiraje me qiradhënësin paraprakisht. **Vetëm 14.3% e studentëve që banojnë me qira kanë lidhur një kontratë noteriale, ndërsa 85.7% e tyre janë marrë vesh vetëm verbalisht me qiradhënësin.**

Gjatë periudhës së izolimit vetëm **17% e studentëve kanë arritur një marrëveshje me qiradhënësin për të mos i paguar ose paguar me këste muajt e izolimit.** 28.3% e studentëve të cilët jetojnë me qira janë detyruar të paguajnë qiranë normalisht. Ndërsa 54.7 % e studentëve nuk e dine akoma se çfarë do ndodhë me pagesën e tyre të qirasë.

30.2% e studentëve i mbulojnë vetë pjesërisht ose plotësisht shpenzimet për sigurimin e studimeve dhe jetesës, ndërsa 68.8% të studentëve shpenzimet ua mbulojnë familjet e tyre.



3.2 AKSESI NË INTERNET

Nisur nga ankesat e shumta për mungesë të aksesit në internet nga nxënësit dhe studentët që zhvillojnë mësimin online qeveria nëpërmjet marrëveshjes me 4 operatorët që ofrojnë internet në vend deklaroi se nga data 20 Mars deri në 30 Prill do të ketë **50% më shumë internet falas**. Kjo ishte një marrëveshje e cila shtonte realisht sasinë e internetit për abonentët që vendosnin të bënin një ri-abonim ose abonim të ri, por nuk ishte një masë e cila mund t'u vinte në ndihmë studentëve apo nxënësve të prekur nga varfëria që nuk kanë mundësi financiare për ti blerë këto paketa interneti apo telefonie. Interneti në këtë rast konsiderohet një tarifë e shtuar pasi është e vetmja rrugë për të marrë shërbim nga universiteti, pavarësisht se studentët paguajnë tarifën vjetore për ta marre këtë shërbim.

Për të ilustruar përfitimin e kësaj mase po sjellim shembullin e njoftimit të Vodafone "Secili prej klientëve tanë me parapagesë do të marrë 50% më shumë internet, sipas paketës që zgjedh. Pra nëse një paketë e blerë përmban 2 GB internet, ju do të përfitoni 3 GB në total" dhe Abcom "Klientët e internetit fiks do të përfitojnë deri në 60% zbritje mbi çmimet e listës nëse bëjnë abonim 4 mujor. Kjo zbritje do të jetë e vlefshme për nivelet e shpejtësisë 15 Mbps, 50 Mbps dhe 100 Mbps" në faqet e tyre zyrtare.³

Paketa e lancuar nga qeveria shqiptare për periudhën 20 Mars – 30 Prill 2020 përmbante:

- 50% më shumë internet falas për 5 javë.
- Akses falas, më shumë internet në çdo platformë edukative.
- Abonentët me kontratë fikse që do të kenë akses në platforma edukative për fëmijë të çdo moshe, 60% më lirë se ofertat normale.
- Zgjatja e ofertave për internet fiks dhe televizor nga Abcom dhe ofertës familjare 3+1 me përmbajtje për fëmijët.
- Ofertë shtesë për çdo paketës të re abonimi Albtelekom. Çdo paketë e re që do të blihet dhe çdo kontratë e re, do të ketë të gjitha ofertat e sipërpërmendura.

Paketa SuperMiks	Paketa me zbritje	V
SuperMiks Internet 8 Mbps	1,400 900 Lekë	
SuperMiks Internet 16 Mbps	1,900 1,400 Lekë	


Nga ana tjetër "**Karta e Studentit**" si një instrument i prodhuar për t'ju ardhur në ndihmë studentëve nëpërmjet shërbimeve dhe produkteve me çmime të reduktuara nuk ofroi shumë mundësi dhe lehtësira për oferta dhe paketa interneti. Gjatë periudhës së izolimit e vetmja marrëveshje apo ofertë e realizuar nëpërmejt përdorimit të Kartës së Studentit ishte oferta nga Albtelekom për studentët duke aplikuar ulje 500 lekë/muaj për internetin me kusht lidhjen e një kontrate 2-vjecare.

Pavarësisht lehtësirave të qeverisë, nevoja e studentëve me vështirësi financiare për akses në internet gjatë kësaj periudhe ka qënë e lartë dhe **detyrimi për të lidhur një kontratë 2-vjecare apo për të bërë abonime të reja në mënyrë që të përfitonin internet nuk shihet si një zgjidhje efektive dhe gjithëpërfshirëse.**

³<https://www.vodafone.al/per-median/lajmerime/mbeshtetje-ndaj-covid19/>

Për të vlerësuar impaktin e masave qeveritare dhe nevojave të studentëve për akses në internet Qëndresa Qytetare u drejtua me disa pyetje lidhur me aksesin në internet studentëve nga 9 universitetet publikë të marra në vlerësim.

40.9% e studentëve të pyetur nuk kanë pasur akses të vazhdueshëm në internet gjatë periudhës së izolimit dhe vetëm 59.1% e tyre kanë siugruar qasje të vazhdueshme në internet.



61% e studentëve që nuk kanë pasur internet thkesojnë se arsyet kanë qënë ekonomike, ndërsa 39% e tyre shprehen se kanë pasur problem teknike për shkak të mungesës së mbulimit të zonës me internet.

Për të kuptuar më thellë problematikën studentët janë pyetur për shokët e tyre të klasës. 54.1% e studentëve pohojnë se vetëm disa nga shokët e klasës kanë qënë të pajisur me internet gjatë periudhës së izolimit, vetëm 14.1% e tyre shprehen se të gjithë shokët e klasës kanë pasur internet të pandërprerë. 1.2% i përkasin mendimit se asnjë prej shokëve nuk ka pasur internet dhe 30.5% e tyre nuk kanë informacion mbi këtë çështje.

Nisur nga fakti që Karta e Studentit është një instrument që mund të sjellë përfitime në cmimet e shërbimeve dhe produkteve ndaj studentëve në këtë periudhë të vështirë studentët u pyetën në lidhje me funksionalitetin dhe efektin e saj. Vetëm 0.8% e studentëve të pyetur shprehen se karta e studentit ka rritur mundësinë e tyre për të aksesuar mësimin online. 64.6% e studentëve pohojnë se Karta e Studentit nuk ka sjellë asnjë minimizim kostosh në blerjen e internetit apo pajisjeve elektronike, ndërsa 34.6% e studentëve nuk kanë informacion mbi ëktë çështje pasi nuk janë pajisur ende me një kartë student.

Sa i përket pjesëmarrjes në mësimin online vetëm 11.3% e studentëve dëshmojnë se 80 - 100% e klasës së tyre ndjekin mësimin online, 54.7% e tyre shprehen se në mësimin marrin pjesë vetëm 40 – 80% e klasës dhe 34% e studentëve pohojnë se në mësimin online marrin pjesë vetëm 0-40% e klasës së tyre.

4 VLERËSIM I PERFORMANCËS SË UNIVERSITETEVE GJATË IZOLIMIT NGA PANDEMIA COVID 19

4.1 QASJA NË KOHË DHE CILËSI E UNIVERSITETEVE NDAJ MËSIMIT ONLINE

Pas Urdhërit të Ministres së Arsimit për të ndërprerë mësimin **në datën 9 Mars**, universitetet ndërprejnë menjëherë mësimin në auditore. Kjo ishte ndërprerja e dytë e mësimit gjatë një viti akademik pas gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Ndryshe nga arsimi parauniversitar i cili pas datës 9 filloi të përshtatet online duke përdorur platforma të ndërtuara privatisht dhe një kanal në RTSH, mësimi në universitete kaloi një periudhë të gjatë të ndërprerë.⁴ Kjo situatë i gjeti universitetet të papërgatitura dhe të pa organizuara për të vijuar mësimin online. Referuar vendimeve të Senateve Akademike dhe Urdhrave të Rektorëve në tabelën e mëposhtme pasqyrohen datat e fillimit të procesit mësimor nga 6 universitetet publike e marra në vlerësim.


⁴<https://www.youtube.com/watch?v=KB2KOpSub5o>

UNIVERSITETI

DATA E FILLIMIT TË MËSIMIT ONLINE


Universiteti i Tiranës	Java e tretë pas izolimit
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	Java e parë pas izolimit
Universiteti “Fan Noli”, Korçë	Java e parë pas izolimit
Universiteti Politeknik i Tiranës	Java e tretë pas izolimit
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	Java e tretë pas izolimit
Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan	Java e tretë pas izolimit
Universiteti Bujqësor i Tiranës	Java e dytë pas izolimit
Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	Java e dytë pas izolimit
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Java e tretë pas izolimit

Pavarësisht vendimeve të organeve drejtuese mbi nisjen e mësimit online, vlerësimi i studentëve tregon se një pjesë e tyre kanë filluar të komunikojnë online mbi literaturën dhe ecurinë e leksioneve para se vetë universiteti të nxirrte këtë vendim. 48.65% e studentëve të pyetur pohojnë se mësimi online ka nisur javën e dytë të izolimit, 45.25% janë shprehur se mësimi ka nisur pas javës së tretë të izolimit dhe vetëm 4.4% deklarojnë se mësimi online ka nisur që javën e parë të izolimit. Vetëm për 1.7% të studentëve ky mësimit nuk ka nisur ende.




Njoftimi mbi mësimin online

Gjatë kohës së izolimit studentët u njoftuan nëpërmjet burimeve të ndryshme të informacionit mbi nisjen e mësimit online. Vetëm 28.37% e studentëve janë informuar nga universiteti, 24.96% nga pedagogët, ndërsa 46.67% e studentëve të pyetur janë informuar për fillimin e mësimit online nëpërmjet mediave, rrjeteve sociale dhe miqve të tyre.



Ndjekja e rregullt e mësimit online

Pas fillimit të mësimit online, vetëm 72.8% e studentëve kanë mundur ta ndjekin mësimin online rregullisht ndërsa 27.2% nuk e kanë ndjekur atë rregullisht. Kjo mungesë në qasjen e mësimit online bazuar edhe në përgjigjet e tjera lidhet drejtpërdrejt me qasjen e studentëve në internet.



4.2 METODOLOGJIA E MËSIMIT DHE VLERËSIMIT ONLINE (PLATFORMAT E- LEARNING)


Sfidat që sjell mësimi në distancë janë të shumta, prandaj edhe institucionet e arsimit të lartë kanë qenë të papërgatitura dhe në mungesë të planeve emergjente për ta zhvilluar mësimin sipas një platforme dhe metodologjie të caktuar. Nga ana tjetër legjislacioni dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë nuk e parashikonin qasjen e mësimit në distancë.

Pavarësisht kësaj universitetet publike dhe jopublike janë të detyruara të ofrojnë shërbimin për studentët të cilët kanë paguar tarifën e shërbimit dhe nga momenti kur organet drejtuese kanë vendosur që mësimi të realizohet online, stafet akademike dhe strukturat drejtuese duhet të vijonin me orarin e mësimit njëjloj si para situatës së Covid 19.

Për të vlerësuar përshtatjen në kohë dhe cilësi të mësimit online Qëndresa Qytetare ka analizuar përgjigjet e pyeteësorit me student lidhur me platformat, metodologjinë dhe mundësitë e vlerësimit nga stafet akademike gjatë mësimit në distancë.

Literatura

86.3% e studentëve e kanë siguruar literaturën nëpërmjet leksioneve të dërguara me e-mail nga pedagogët, 9.2% nëpërmjet librave të skanuar, ndërsa 4% nëpërmjet blerjes së librave në librari. Pavarësisht se gjatë vitit 2019 qeveria shpenzoi rreth 700 000 dollarë për të blerë Bibliotekën Dixhitale www.ulibrary.rash.al, vetëm 0.6% apo 4 studentë gjithësej kanë shfrytëzuar këtë bibliotekë për të siguruar literaturën e mësimit online.



4.3 ANALIZË KRAHËSIMORE ME UNIVERSITETIN E PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

Bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës, si pasojë e pandemisë COVID-19, Universiteti i Prishtinës ka ndërpre mësimin në të gjitha njësitë akademike më datë 11 Mars, 2020. Mësimi online në Universitetin e Prishtinës ka filluar me datë 16 Mars, 2020 (pra mësim nuk është mbajtur vetëm dy dite pune, praktikisht).


Sipas intervistës së zhvilluar me Prorektorin (zvendës Rektor) e Universitetit të Prishtinës Profesor Hysen Bytyqi Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Të gjithë studentët janë pajisur me email elektronike zyrtare në GOOGLE Education
- I gjithë Stafi Akademik tashmë ka qasje në emailët zyrtarë të Google
- Ndryshimet e SEMS (sistemi informatik i studentëve) janë përshtatur për të lejuar stafin të shkarkojnë listat me email-et e studentëve në mënyrë që të mund të komunikoni me ata për mësim, shkarkimi e listës së evidencës së mbajtjes së mësimin (apeli i pjesëmarrjes).

Ky proces është mundësuar falë asaj se Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" ka qasje në Google Education në mënyrë që të mund të përdorim shërbimet e mëposhtme:

- **Google meet** - për ligjëratat, duke takuar studentë virtualisht; video konferencë, e cila mund të përdoret për të krijuar seanca dhe shpërndarjen e kodit të sesionit, i cili mundëson pastaj që studentët të përfshihen në leksionin që mësohet direkt nga mësuesi.
- **Google Classroom** - për krijimin e grupeve lëndore, shkëmbimin e detyrave, shpërndarjen e materialeve në mënyrë interaktive me studentët dhe mësuesin.

Universiti i Prishtinës nëpërmejt përdorimit të sistemit informatik të studentëve të lidhur me google ka monitoruar të gjitha leksionet dhe mësimin e zhvilluar online në kohë reale.⁵ Në tableën e mëposhtme shohim të dhënat e mësimdhënies nga data 16 Mars deri në 11 Prill 2020.



Vlen të përmendet se veç pas tre javësh mësimi on-line, u regjistruan rreth **14.000 ligjërata** me studentë, ku morën pjesë rreth **1200 mësimdhënësit**. Në të gjitha seancat mësimore të zhvilluara on-line morën pjesë rreth **200 mijë studentë**, gjë që i tejkalon të gjitha pritjet tona nga fillimi këtij aktiviteti.

Shifrat e paraqitura më lartë demonstronë interesin e jashtëzakonshëm dhe pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në mësimdhënie/mësimnxënie virtuale. Kohëzgjatja e ligjëratave dhe oraret kanë qenë të njëjta, sipas orarit të prezantuar në fillim të vitit akademik 2019/20, gjë që e bën këtë formë të komunikimit on-line një mënyrë të suksesshme për vazhdim të mësimin në një kohë kur COVID-19 është shpallur pandemi.

⁵<https://app.powerbi.com/view?r=eyJrIjoimDBkNWMzY2EtMGVhZC00YWMwLTk2MDYtNjk0MwZmE1MTRliwi dCI6ImMwMzRjM2IOLWQwMmltNDM2MS04M2YwLTNiMWI5ZWE0MzcwYyIsImMiOjh9>

4.4 ANALIZË E INVESTIMEVE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË PLATFORMAT INFORMATIKE

Universitetet e përfshira në këtë vlerësim kanë shpenzuar shumë para nga tarifat e studentëve për të siguruar pajisje, mirëmbajtje dhe akses në sisteme informatike, por situata e emergjencës e shkaktuar nga pandemia Covid 19 tregoi se ato u përshtatën me vonëse dhe nuk ishin të gatshme për të ofruar një platformë dhe sisteme informatikë ku të inshte e integruar mundësia e mësimit online.

Qëndresa Qytetare monitoron prej vitit 2017 shpenzimet e universiteteve dhe në tabelën më poshtë ka parqitur vlerat e shpenzimeve vetëm për vitin e fundit akademik të 6 universiteteve për pajisje, mjete dhe mirëmbajtje të sistemeve informatike.

Shpenzimet për mjete dhe pajisje informatike nga 6 universitetet e vlerësuara për vitin akademik 2018 – 2019.

Zëri i shpenzimit	Shuma e shpenzuar
Telefon dhe internet	31 000 Euro
Instalim dhe mirëmbajtje rrjetesh informatike	160 000 Euro
Pajisje informatike	830 000 Euro
Mjete dhe pajisje teknike	870 000 Euro
Totali	1.891.000 Euro

Universitetet e monitoruara gjatë vitit akademik 2018 - 2019:

Universiteti i Tiranës

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Universiteti “Fan Noli”, Korçë

Universiteti Politeknik i Tiranës

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

Universiteti i Tiranës, që është edhe universiteti më i madh në vend prej vitit 2018 ka një **sistem informatik jashtë funksionit**. Për shkak të një konfliktit të brendshëm mes Rektorit dhe ish-kancelarit të universitetit, ky sistem vijon të jetë provë material në prokurori.⁶ Ky sistem **ka kushtuar mbi 1 milion euro** dhe është **mirëmbajtur për 3 vite rresht me rreth 500.000 euro** në vit. Ndërkohë Universiteti i Prishtinës shpenzon rreth 100.000 euro në vit për mirëmbajtjen e sistemit informatik.



⁶<https://exit.al/shkeljet-qe-ministria-e-arsimit-i-gjeti-rektorit-koni-exit-shpjegon/>

4.5 KRAHËSIMI DHE RANKIMI I 9 UNIVERSITETEVE PUBLIKE

Nisur nga autonomia që ligji 80/2015 u jep universiteteve publike për të vepruar edhe në situatë të tilla emergjente, ky rankim shërben për të kuptuar se si në menyre të diferencuar i janë pergjigjur universitetet situatës, masat që kanë drejtuesit e tyre dhe si kanë ndikuar ato në rritjen e performancës gjatë emergjencës për secilin Universitet.

Ne grafiket me poshte mund te krahesoni se si studentet jane pergjigjur pyetjeve:

Kur filluat mësimin online?, Si u njoftuat për fillimin e mësimin online? Sa efektiv ka qënë mësimi online ?, Sa efektive kanë qënë stafet akademike gjatë periudhës së Covid 19?, A janë respektuar oraret e mësimin nga pedagogët në fakultetin tuaj? Mësimin e keni zhvilluar nëpërmjet?



Ky rankim është bazuar në reagimin dhe performancën e treguar nga 9 universitetet e përfshira në vlerësim gjatë kohës së izolimit për shkak të pandemisë Covid 19. Secili tregues që mat performancën përmban një vlerësim nga 0 deri 20 pikë dhe për çdo 10 pikë universiteti vlerësohet me një notë. Metodologjia e vlerësimit siguron transparencë, objektivitet, panashmëri dhe barazi në gjykim duke u bazuar 100% në vlerësimet që 720 studentë kanë dhënë për universitetet e tyre.

Universiteti	Nota	Koha e fillimit të mësimit on.	Njoftimi mbi fillimin e mësimit on.	Efektiviteti i mësimit on.	Korektesia e orareve	Metodologjia e mesimit on.
Universiteti Bujqësor	6	★ ☆	★ ☆	☆ ☆	★ ★	★ ★
Universiteti I Durrësit	5	★ ★	★ ☆	★ ☆	★ ☆	☆ ☆
Universiteti Korçës	5	★ ★	★ ☆	★ ☆	★ ☆	☆ ☆
Universiteti i Tiranës	4	☆ ☆	★ ☆	☆ ☆	★ ☆	★ ★
Universiteti i Mjekësisë	4	☆ ☆	★ ☆	☆ ☆	★ ☆	★ ★
Uni.Politeknik i Tiranës	4	☆ ☆	★ ★	☆ ☆	★ ★	☆ ☆
Universiteti i Shkodrës	4	☆ ☆	☆ ☆	☆ ★	☆ ★	★ ★
Universiteti i Vlorës	4	☆ ☆	☆ ★	☆ ★	★ ★	☆ ☆
Universiteti i Elbasanit	1	☆ ☆	☆ ☆	☆ ☆	★ ☆	☆ ☆

Ky rankim është bazuar në reagimin dhe performancën e treguar nga 9 universitete gjatë kohës së izolimit për shkak të pandemisë Covid 19. Secili tregues që mat performancën përmban një vlerësim nga 0 deri 20 pikë dhe për çdo 10 pikë universiteti vlerësohet me një notë. Metodologjia e vlerësimit siguron transparencë, objektivitet, panashmëri dhe barazi në gjykim duke u bazuar 100% në vlerësimet që 720 studentë kanë dhënë për universitetet e tyre.

Tabela e detajuar e vleresimit

UNIVERSITETI	Fillimi i mësimit online	Njoftimi mbi fillimin e mësimit online	Efektiviteti i mësimit online	Respektimi i orareve	Metodologjia e mesimit	Vlerësimi (nota) 10 pikë – 1 notë
Universiteti Bujqësor i Tiranës	Java e dytë pas izolimit 10 Pikë	32.35% nga Universiteti 10 Pikë	60% mësimi joefektiv 0 Pikë	64.71% korrektë 20 Pikë	67.65% video – call 20 Pikë	6
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës	Java e parë pas izolimit 20 Pikë	30.65% nga Universiteti 10 Pikë	50% efektiv 10 Pikë	51.61% disi korrektë 10 Pikë	66.13% Leksione më e-mail 0 Pikë	5
Universiteti “Fan Noli” Korçë	Java e parë pas izolimit 20 Pikë	25.49% nga Universiteti 10 Pikë	37.25% disi efektiv 10 Pikë	58.82% disi korrektë 10 Pikë	76.47% Leksione më e-mail 0 Pikë	5
Universiteti i Tiranës	Java e tretë/katërt pas izolimit 0 Pikë	Vetëm 25.09% nga Universiteti 10 Pikë	56.99% mësimi joefektiv 0 Pikë	44.44% disi korrektë 10 pikë	55.56% video – call 20 Pikë	4
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Java e tretë/katërt pas izolimit 0 Pikë	38.46 nga Universiteti 10 Pikë	64.62% mësimi joefektiv 0 Pikë	46.15% disi korrektë 10 Pikë	66.15% video – call 20 Pikë	4
Universiteti Politeknik i Tiranës	Java e tretë/katërt pas izolimit 0 Pikë	60% nga Universiteti 20 Pikë	60% mësimi joefektiv 0 Pikë	60% korrektë 20 Pikë	64% Leksione më e-mail 0 Pikë	4
Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër	Java e tretë/katërt pas izolimit 0 Pikë	11.11% nga Universiteti 0 Pikë	38.89% disi efektiv 10 Pikë	55.56% disi korrektë 10 Pikë	61.11% video – call 20 Pikë	4
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë	Java e tretë/katërt pas izolimit 0 Pikë	30.61 % nga Universiteti 10 Pikë	32.6% disi efektiv 10 Pikë	51.02% Korrektë 20 Pikë	55.10% Leksione më e-mail 0 Pikë	4
Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan	Java e tretë/katërt pas izolimit 0 Pikë	18.03% nga Universiteti 0 Pikë	59.02 % jo efektiv 0 Pikë	50.82 disi korrektë 10 Pikë	80.33% Leksione më e-mail 0 Pikë	1

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË IAL-VE PUBLIKE

Indikatorët	Pikëzimi sipas indikatorëve
Momenti i fillimit të mësimit online	Java e parë pas izolimit – 20 Pikë Java e dytë pas izolimit – 10 Pikë Java e tretë/katërt pas izolimit – 0 Pikë
Njoftimi i studentëve mbi fillimin e mësimit online	Mbi 50% e studentëve të njoftuar nga universiteti – 20 pikë Mbi 25% e studentëve të njoftuar nga universiteti – 10 pikë Nën 25% e studentëve të njoftuar nga universiteti – 0 pikë
Efektiviteti i mësimit online	Mbi 50% Efektiv – 20 Pikë 30 – 100 % Disi efektiv – 10 Pikë Mbi 50% Jo efektiv – 0 Pikë
Respektimi i orareve të mësimit	Mbi 50% Korrektë – 20 Pikë 30 – 100 % Disi korrektë – 10 Pikë Mbi 50% Jo korrektë – 0 pikë
Metodologjia e mësimdhënies online	Mbi 50% Video - takime me studentet – 20 pikë 30 – 100 % Leksione te regjistruara video ose audio – 10 pikë Mbi 50% Leksione të dërguara me e-mail – 0 pikë

5.GJETJET KRYESORE

- **Vetëm 14.3% e studentëve që banojnë me qira kanë lidhur një kontratë noteriale, ndërsa 85.7% e tyre janë marrë vesh verbalisht me qiradhënësin. 17% e studentëve që banojnë me qera kanë arritur një marrëveshje me qiradhënësin, ndërsa 28.3% e tyre janë detyruar të paguajnë qiranë normalisht. 54.7 % e studentëve nuk e dine akoma se çfarë do ndodhë me pagesën e tyre të qirasë.**
- **40.9% e studentëve nuk kanë pasur akses të vazhdueshëm në internet gjatë periudhës së izolimit** përkundrejt 59.1% të studentëve që kanë siugruar qasje të vazhdueshme në internet. **61% e studentëve që nuk kanë pasur internet thkesojnë se arsyet kanë qënë ekonomike,** ndërsa 39% pasur problem teknike për shkak të mungesës së mbulimit të zonës me internet.
- **Vetëm 0.8% e studentëve shprehen se Karta e Studentit ka rritur mundësinë e tyre për të aksesuar mësimin online.** 64.6% e studentëve pohojnë se Karta e Studentit nuk ka sjellë asnjë minimizim kostosh në blerjen e internetit apo pajisjeve elektronike, ndërsa 34.5% e tyre rezultojnë të mos jenë pajisur ende me një Kartë Studenti.
- 6 nga 9 universitetet e vlerësuara rezultojnë ngelëse në qasjen ndaj mësimin online. **Në vend të parë renditet Universiteti Bujqësor i Tiranës me notën “6” dhe në vend të fundit Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan me notën “1”.**
- **48.65% e studentëve të pyetur pohojnë se mësimi online ka nisur javën e dytë të izolimit, 45.25% janë shprehur se mësimi ka nisur pas javës së tretë të izolimit, 4.4% deklarojnë se mësimi online ka nisur që javën e parë të izolimit. Vetëm për 1.7% ky mësim nuk ka nisur ende. Ndërkohë mësimi online në Universitetin e Prishtinës ka nisur vetëm dy ditë punë pas ndërprerjes së mësimin fizik.**
- **86.3% e studentëve e kanë siguruar literaturën nëpërmjet leksioneve të dërguara me e-mail nga pedagogët, 9.2% nëpërmjet librave të skanuar ,ndërsa 4% nëpërmjet blerjes së librave në librari. Pavaërsisht se gjatë vitit 2019 qeveria shpenzoi rreth 700 000 \$ për të blerë Bibliotekën Dixhitale www.ulibrary.rash.al, vetëm 0.6% e studentëve kanë shfrytëzuar këtë bibliotekë për të siguruar literaturën e mësimin online.**
- **Universitetet e monitoruara financiarisht nga Qendresa Qytetare kanë shpenzuar 1.891.000 euro për pajisje dhe sisteme informatike por studentët vijojnë mësojnë në platforma virtuale private. Universiteti i Prishtinës shpenzon rreth 100.000 euro në vit për mirëmbajtjen e sistemit informatik dhe ofron kete sistem si platforme mbeshtetes per shërbimin e mësimin online.**

6. REKOMANDIME

- **Qeveria** duhet të përfshijë në Aktin Normativ **Nr. 12, datë 2.4.2020 ribursimin e qirasë së muajve mars – prill 2020** për studentët nëpërmjet akordimit të një bonus qiraje 100 euro në muaj ose kompesim nëpërmjet mospagimit të tarifave të studimit deri në kompesimin e kësaj vlere për muajt e izolimit.
- **Këshillat Bashkiake dhe bashkitë universitare** si zotëruese 100% të aksioneve të rezidencave studentore të trajtimit të studentëve duhet të rivlerësojnë dhe të mundësojnë kthimin e tarifave të paguara nga studentët që banojnë në konvikte për periudhën e izolimit për studentët që e kanë paguar tarifën e plotë dhe nuk i kanë shfrytëzuar godinat dhe shërbimet e konvikteve.
- **Qeveria, organet e qeverisjes vendore dhe universitetet** duhet të akorodjnë fond specifik për sigurimin e qasjes në internet për të gjithë studentët. Pajisja e tyre mund të realizohet në bashkëpunim me operatorët që ofrojnë internet nëpërmjet identifikimit me Kartën e Studentit ose regjistrat e universiteteve.
- **Minsitria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë** duhet të bëjë ndryshimet e nevojshme ligjore për të parashikuar dhe njohur mësimin online (distance learning) si pjesë e formave të mësimdhënies në ligjin 80/2015. **Universitetet publike dhe jopublike** duhet të hartojnë planet e emergjencës për të shndërruar në një kohë më të shkurtër mësimin nga online në fizik.
- **Universitetet publike** duhet të përgatizojnë udhëzues mbi metodologjinë e vlerësimit të studentëve online përpara se të fillojë sezoni i provimeve dhe module të posacme për sistemet e mbikqyrjes së mësimin online. Vlen të shqyrtohet modeli i monitorimit të mësimin në kohë reale të realizuar nga Universiteti i Prishtinës.
- **Këshillat dhe organizatat studentore** duhet të angazhohen për të identifikuar nevojat e studenëve për qasje në internet, mungesë të pajisjeve dixhitale dhe literature duke nisur një fushatë kombëtare donacionesh për mundësimin e aksesit në arsim të të gjithë studentëve.
- Qeveria dhe 61 bashkitë duhet të **marrin masa për të shtrirë mbulimin me valë interneti në të gjithë territorin e vendit** duke përfshirë edhe zonat periferike të thella për t'i mundësuar çdo studenti dhe nxënësi qasje në mësimin online.

Ky studim u realizua nga Qëndresa Qytetare në kuadër të projektit “Arsimi në Fokus”, me mbështetjen financiare të qeverisë suedeze dhe Olof Palme Center. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

**QENDRESA
QYTETARE**



**OLOF PALME
INTERNATIONAL
CENTER**

